



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ Prot

Vau Dejes me _____ / _____ 2020

V E N D I M

Nr. 58 Datë 26.10 2020

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1” (ndryshuar), neni 55 pika 4, të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr 38/2019, ligji nr 8744 datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, ndryshuar, në VKM nr 566 datë 22.08.2012, “Për miratimin e listes perfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen ne pronësi ose në përdorim të Komunes Hajmel, Qarku Shkodër”. (Sot Nj.Administrative Hajmel, Bashkia Vau Dejes).

Si dhe pas shqyrtimit të **Projekt-Vendimit Nr 02.date 18.10.2020**, paraqitur nga Drejtoria Juridike Prokurimeve dhe Integritit, Sektori i Aseteve, ku propozohet ti jepet në përdorim banorëve të fshatit Nënshat, një sipërfaqe toke prej 2000 m², (prone e Bashkise Vau Dejes), si shtesë e sipërfaqes ekzistuese të varrezave të këtij fshati.

Pas diskutimit dhe miratimit me shumicë të cilësuar të votave.

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I

1. Miratimin e dhënjes në përdorim banorëve të fshatit Nënshat, të një sipërfaqe toke (shesh) prej 2000 m², si shtesë e sipërfaqes ekzistuese të varrezave të fshatit.
2. Ngarkohen Drejtoria Juridike Prokurimeve dhe Integritit, Sektori i Aseteve, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

ZV/K R Y E T A R

Ervis SHIMAJ

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ardian ÇELEPIJA

Miratuar me 24 vota

Vota Pro 24

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me date 30.10.2020





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

23.09.2020

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASETETEVE

Nr 5501 Prot

Projekt Vendim

Nr 02. Datë 18.09.2020

Nisur nga kërkesa e banorëve të fshatit Nënshat, si dhe mbështetur ne ; Ligjin nr 139/2015 “Per vetqeverisjen vendore”, nenet 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1”(ndryshuar), neni 55 pika 4, ligji nr 38/2019, ligji nr 8744 date 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike te shtetit ne njesite e qeverisjes vendore”,ndryshuar. Ne VKM nr 566 date 22. 08. 2012 “Per miratimin e listes perfundimtare te pronave te paluajtshme publike, shteterore, që transferohen në pronesi ose në përdorim të komunes Hajmel (sot Nj. Administrative Hajmel) Bashkia Vau Dejës të Qarkut Shkoder.

PROPOZOJME

Ti jepet në përdorim banorëve të fshatit Nënshat një sipërfaqe toke prej 2 dynym, si shtesë e sipërfaqes ekzistuese te varrezave e fshatit.

Sipërfaqja e tokës ndodhet në fshatin Nënshat, Zk 2778, me Nr Pasurie 1, është e llojit shesh, pronë e Bashkise Vau Dejes, ndodhet me nr 192 në fleten e inventarit, transferuar me VKM nr 566 datë 22.08.2012 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Hajmel.

Bashkëlidhur kërkesën e kryesise së fshatit Nënshat, shoqëruar me firmat e kryefamiljarëve, si dhe plan rilevimin e pronës.

NE MUNGESHE DHE ME URDHER
ZV/KRYETARI
KRISTIAN SHKRELI

KRYETARI
MARK BABANI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KRYESIA E FSHATIT NENSHATE

Nr. 4838 P₁₀₇

Dt 26.08.20

KERKESE



[Handwritten signature]

Drejtuar: Keshillit te Bashkise VAUDEJES

Per dijeni : Zotit Mark Babani, Kryetar I Bashkise VAUDEJES

Tuj falenderu Keshillin dhe Kryetarin e Bashkise, per mbeshtetjen qe i keni dhane Kryesise se fshatit tone per zbatimin e disa projekteve ne interes te komunitetit si rregullim rrugesh neper lagje, rregullim urash , vendosje tubash betoni ne kanale, pastrim kanalesh kulluese e vaditese ne kohen e duhun etj. ,pune qe nuk jane kry asnjehere ne fshatin tone prej tridhjetete vjetesh, kerkojme nderhyrjen Tuaj per :

ZGJERIMIN E VARREZAVE TE FSHATIT NENSHAT (edhe me 50 % te siperfaqes egzistuese)


Me gjithe ndarjen qe i eshte ba me fillimin e perdorimit te kesaj siperfaqe toke si vend varrezash, sot nuk plotson nevojat tona per varre. Me dijenine tone toka qe mund te perdoret per zgjerim , me kadaster rezulton Toke shtet.

Mbetemi me shprese se kerkesa jone do te merret ne konsiderate.

KRYESIA E FSHATIT NENSHATE

- | | | | |
|----|-----------------------|-------|--------------------|
| 1. | <u>Nedrak Bardhi</u> | firma | <i>[Signature]</i> |
| 2. | <u>Zef Daga</u> | firma | <i>[Signature]</i> |
| 3. | <u>Enxhela</u> | firma | <i>[Signature]</i> |
| 4. | <u>Ngjeron Breci</u> | firma | <i>[Signature]</i> |
| 5. | <u>Pjeter K. Pali</u> | firma | <i>[Signature]</i> |
| 6. | _____ | firma | _____ |
| 7. | _____ | firma | _____ |
| 8. | _____ | firma | _____ |
| 9. | _____ | firma | _____ |

KRYETARI I FSHATIT



V.O bashkengjitur eshte dhe lista e banoreve qe kerkojne zgjerim varrezave ne fshatin Nenshat



EDMOND S. PREK 067 5060 238 EP

Elvis Joci 067 437 5642

ROBIL LAZRI 067 258 7375

Edmond Hila - 067 302 4522

Valentin Simoni 067 351 4374

Gezgj Mesuli 067 542 8559

Agim Shtjeka

Simon Gjergji

Mica Franje

Klodian Topalli 067 303 0747

Shtjeka Adoje 069 310 2619

Gara Topalli

Gjergj Topalli

Pan Topalli

Prek Hila

Martin Mesuli

Zef Topalli

Marta Z. Boda

Udrake Gj Topalli

Hil Kaja

Zef Joci

Zef Doci



PLAN RILEVIM

PERGATITI

Emri mbiemri: HAMID ÇULIQ

Licensa Nr. T-675/2 date 10.04.2018

Data e pergatitjes: 22.09.2020

Siperfaqe: S=2000 m²

ING. TOPOGRAF
HAMID ÇULIQ
NR LIÇENSE-T0675/2



Vula Firma

IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE : 2778

NUMRI I PASURISE : 1 VOL. 1 FQ. 1


INDEKSI I HARTES : K - 34 - 76 - (54 - A),(54 - C)

SHKALLA : 1:2500

ADRESA E PASURISE:

Fshati Nenshat Rrethi Shkoder

PRONARI/ET : BASHKIA VAU DEJES





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 754/1 prot.

Shkodër, më 10.11.2020



LËNDA: Mbi vendimin Nr.58 datë 26.10.2020 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.

KËSHILLIT TË BASHKISË VAU-DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që te ligjit nr.107/2016 dt 2.10.2016 “Për Prefektin” nenit 9 pika 1/1.2 germa a dhe c, neni 18, neni 23 pika 7, nenit 54 shkronja “e/1”, nenit 55 pika 3, neni 64/c të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, VKM Nr.566 22.08.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Hajmel, Qarku Shkodër”, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”si dhe aneksi I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, shqyrtoi **VKB Nr.58 datë 26.10.2020** “Për miratimin e dhënies në përdorim banorëve të fshatit Nenshat¹ NJAD Hajmel, një sipërfaqe toke (shesh) prej 2000 m², si shtesë e sipërfaqes ekzistuese të varrezave të fshatit”.

Për sa trajtuar, konstatohet si vijon:


Shërbimi i varrezave është një ndër funksionet vendore të Bashkisë referuar nenit 23/7 e Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar,

Kjo vendimmarrje nuk ka të specifikuar aktin ligjor/nënligjor për trajtim të këtij rasti, si pasojë për shqyrtim dhe analizim të mëtejshëm kërkohet depozitimi i relacionit për procedurën ligjore dhe çertifikatën e pronësisë (në mungesë të saj statusin juridik nga ASHK-ja), siaps *Kreut II, neni 4, pika 1/b* e Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI



¹ VKB është i paemërtuar, citimi në pikën 1 të VKB nuk është i formuluar saktë sipas nenit 54/e/1 të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Per vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar në të cilën citohet Këshilli ... miraton dhënien në përdorim të pronave të tretëve ose dhënien për zhvillim të pronës nepërmjet bashkëpunimit me subjekte private.